



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 107, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e variantit të ri të projektit të rikualifikimit urban të Pazarit të Ri, Markatës së Mishit - Fruta - Perime dhe Sheshit "Avni Rustemi" me këto vërejtje:
 - *Tek Objekti nr. 3 që i nënshtrohet restaurimit:*
 - Të hiqet baxhoja nga çatia;
 - Dritaret e krahut të djathtë të objektit të realizohen si dritaret e krahut të majtë i objektit.
 - *Tek Objekti nr. 4 që i nënshtrohet restaurimit:*
 - Kanatet e vetratave të bëhen të drejta (sipas fotove të vjetra të objektit).
 - *Për markatën e mishit dhe të peshkut:*
 - Të vlerësohet mundësia e eliminimit të tiranteve perimetrale.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI